



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.02.2021, ora 09:45

Drejton mbledhjen:

Ilir Beqaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Ilir Beqaj, Halil Jakimi, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama, Edmond Leka dhe Zef Shtjefni.

Mungojnë:

Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Dritan Bici, Besnik Baraj dhe Halit Valteri.

Të ftuar:

Violanda Theodhori – Drejtor, Departamenti i Çështjeve juridike dhe licencimit në AMF

Lyela Rama – Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve në AMF

Ergys Misha – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Ilir Beqaj – Mirëmëngjesi, kolege e kolegë deputetë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, data 18.02.2021, ora 09:43.

Kemi kërkuar dje nga propozuesit disa riformulime. A keni mundur t'i përgatisni?

Violanda Theodhori – Po, ne lamë për riformulim nenin 7, pikat 2 dhe 3, të cilat i kemi riformuluar, si dhe heqim pikën 9 të këtij neni, ashtu siç e diskutuam.

Atëherë, neni 7, pika 2, pas fjalëve "...dhe depoziton në autoritet bazat teknike," pas presjes shtohen fjalët "faktorët e riskut" dhe fjalia vazhdon "...dhe vlerësimet aktuariale të përdorura për llogaritjen e këtyre primeve, të shoqëruara me opinionin e aktuarit të autorizuar të shoqërisë."

Te pika 3 pas fjalëve "...me parimet aktuariale" shtohen "ose faktorët e riskut të përcaktuar me rregullore nga autoriteti."

Ilir Beqaj – Pra, nuk duhet lidhëza "dhe"? Ju mendoni se duhet të vendoset lidhëza "ose"?

Violanda Theodhori – Pra, "...në përputhje me parimet aktuariale ose faktorët e riskut të përcaktuara me rregullore nga autoriteti."

Po e lexoj të gjithë pikën 3 të nenit 7: "Autoriteti, në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, urdhëron rishikimin e tarifave të reja të primeve nëse konstaton se baza e të dhënave për hartimin e tabelave të primit nuk është e saktë ose shoqëria e sigurimit nuk ka vepruar në përputhje me parimet aktuariale ose faktorët e riskut të përcaktuar me rregullore nga autoriteti."

Ilir Beqaj – Mendoj se duhet "...dhe faktorët e riskut", sepse parimet aktuariale ju i keni gjithmonë.

Violanda Theodhori – Dakord!

Në fakt, ne donim ta ndanim, pra të urdhëronim edhe rishikim tarifash për këtë ose edhe për këtë tjetrën, megjithatë edhe lidhëza "dhe" është në rregull.

Ilir Beqaj – A mundet ai të veprojë pa parimet aktuariale?

Violanda Theodhori – Normalisht jo.

Ilir Beqaj – Atëherë, këtë merak kam unë.

Violanda Theodhori – Nuk ka asnjë problem.

Procedurën me rregullore nga autoriteti e ngjitem lart dhe pikën 9 të nenit 7, siç sugjeruat edhe ju, e hoqëm.

Ilir Beqaj – Kush është dakord me riformulimin e pikave 2 dhe 3 të nenit 7? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8.

Violanda Theodhori – Te neni 8 nuk kemi ndonjë ndryshim. Ne vetëm për nenin 7 e kemi bërë propozimin.

Ilir Beqaj – Dakord, por problemi është se thamë me të drejtë apo me detyrim, nëse ju kujtohet. Ne këtë diskutim bëmë.

Violanda Theodhori – Ne e diskutuam me grupin e punës dhe mundësia e zbatimit të sistemit është opsionale dhe pikërisht këta faktorë rreziku, që ne do të nxjerrim me rregullore, do të jenë të detyrueshëm nga shoqëria. Pikërisht një nga këta faktorët e riskut do të jetë i lidhur edhe me masa ose me urdhërim të kthimit të tabelave. Gjithashtu, meqenëse ju thatë se rregulloret do të shtyhen për 6 muaj, ne u kemi lënë shoqërive 6 muaj që të përgatisin faktorët e riskut që do të përshtaten sipas modelit.

Ilir Beqaj – Dua t'ju bëj një pyetje. Nëse unë bëj një policë sigurimi shëndeti dhe, sigurisht, pas 5 vjetësh nuk e kam përdorur atë policë. Vitin e gjashtë shoqëria a do të më japë ndonjë bonus lidhur me shëndetin?

Violanda Theodhori – Polica e shëndetit është një policë vullnetare, kurse këtu flasim për polica sigurimi të detyrueshme.

Ilir Beqaj – Nuk ka rëndësi. Atëherë, po ta bëj pyetjen ndryshe. Ne kemi sot 100 makina të siguruara, 3 apo 4 prej tyre në përqindje bëjnë aksident, kurse 96 të mbeturat, sipas këtij parimi, mund të kenë të drejtën e bonusit.

Violanda Theodhori – Kryetar, sistemi anon më tepër për *malus*-in, pra që do të thotë se ...

Ilir Beqaj – Po, sepse, në qoftë se do të vazhdomë me këtë parim...

Violanda Theodhori – Pra, në qoftë se një person ka bërë shumë aksidente, sigurisht edhe bonusi qëndron, por nuk do t'i rritet primi. Pra, në të njëjtin prim do të mbete personi, i cili nuk ka bërë aksidente që nuk hyn te faktorët e rrezikut.

Ilir Beqaj – Pra, këtu s'kemi bonus?

Violanda Theodhori – Jo.

Ilir Beqaj – Nëse do të ecim me këtë logjikë, i bie që për 10 vjet, sikur unë të jem gjithmonë i mirë, duhet të ma falë dhe nëse ma fal, njeri koncepti i *risk pooling*, i cili ka shpikur sigurimet, fillon të bjerë ose pastaj do të bëhet që atij personi që ka *malus* do t'i shkojë në stratosferë primi.

Violanda Theodhori – Në stratosferë jo, por do të jenë ato tabelat përkatëse se deri ku shkon.

Ilir Beqaj – Pra, primet e të këqijve do të mbulojnë të gjitha kostot pastaj, në qoftë se dalin të mirët gradualisht.

Violanda Theodhori – Ne mund t'ju paraqesim edhe një material të detajuar se si funksionon sistemi që aktuarët e kanë përgatitur me matricën e përcaktimeve që të jeni në dijeni. Gjithsesi, këto tabela do të konsultohen para se të vendosen nga faktorët e riskut, siç janë edhe modelet europiane.

Ilir Beqaj – Dakord!

Faktikisht pas të gjitha këtyre viteve që ne flasim për këtë gjë, jemi ende në diskutimet në parim, unë nuk shikoj ndonjë fillim zbatimi të afërt të këtij funksioni, instrumenti apo çfarë mund të quhet.

Violanda Theodhori – Për ne është arritje, pasi të paktën autoriteti ka që në vitin 2011 që ka një regjistër dëmsh dhe ka të identifikuar shkaktarët e dëmeve të automjeteve.

Ilir Beqaj – E kuptova.

Tani dua të bëj një pyetje. A ka informacion siguruesi im se sa herë futem unë me semafor të kuq?

Violanda Theodhori – Jo, këtë nuk e ka, pasi duhet bërë një ndërlidhje me sistemin e pikëve të patentës që më pas edhe ky të quhet një faktor...

Ilir Beqaj – Nuk po flas për pikët, se mund të ketë patenta me pikë dhe patenta pa pikë, por po them nëse unë futem me të kuqe dhe marr gjobë. Pra, nuk kam bërë asnjëherë aksident, por jam...

Violanda Theodhori – Këto janë ndërlidhje në proces. Ne jemi një grup pune, qoftë me DPSHTRR-në, qoftë me Policinë Rrugore për sigurinë rrugore dhe jemi duke menduar se si

mund të ndërlihen të gjitha sistemet, në mënyrë që të merret informacion i saktë qoftë për prerjen e policave.

Ilir Beqaj – Përtej të gjitha vendimeve tuaja, tani po bëjmë ligjin për t'i kthyer vendimet në instrumente ligjorë. Nëse ne mbarojmë ligjin, dhe ai, për shembull, hyn në fuqi për dy muaj, ndërkohë ju ende keni mendime se si ta rregulloni këtë gjë, ky është momenti që mendimet të marrin kornizën ligjore.

Violanda Theodhori – Kjo u ka shkuar edhe autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ligjit, siç është Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes. Pra, ligji ka qenë i hapur për konsultim...

Ilir Beqaj – Unë besoj se të interesuarit jeni ju, si propozues, Policia Rrugore nuk është shumë e interesuar se çfarë ndodh me policat e sigurimit.

Violanda Theodhori – Kryetar, më fal, por është e kundërta. Ligji bëhet për sigurimin e detyrueshëm, nuk bëhet për policat e sigurimit, ajo është dytësore që këto duhet të mbulohen, sepse janë shpenzime për dëmet dhe mbulohen nga shoqëritë e sigurimit. Por përgjegjësia për t'u pajisur me policë, që shteti të mos mbulojë dëmet që u shkaktohen shtetasve të vet, është përgjegjësi nga direktiva dhe shtetet duhet ta bëjnë të zbatueshme nëpërmjet mekanizmave zbatimin e...

Ilir Beqaj – Më fal, por kështu si po e shtroni ju, le të vendosim një tarifë fletë për këdo, zëre se është një taksë.

Violanda Theodhori – Është përcaktimi i faktorëve të riskut...

Ilir Beqaj – Për këtë po të pyes. Unë që futem me të kuqe dhe gjobitem ky faktor risku si merret në konsideratë nga ju?

Violanda Theodhori – Do ta vendosim në rregullore, meqenëse e kemi lënë në rregullore se mund jenë 45 faktor risku, këtu le të jetë edhe futja me të kuqe si faktor risku.

Ilir Beqaj – Futjen me të kuqe e dhashë si ilustrim, sepse për shkeljen e Kodit Rrugor mund të ketë faktorë të ndryshëm. Si do ta përfitoni këtë informacion? A jeni në diskutime me grupe pune? Nuk më mjafton mua si ligjvënës që ta miratoj ligjin.

Violanda Theodhori – Ne mirëpresim çdo propozim tuajin.

Ilir Beqaj – Jo, jo, ju që punoni për këtë gjë, çfarë mund t'i shtojmë ne këtij ligji, që ata të tjerët të kenë detyrimin t'ju informojnë rregullisht edhe për gjobat?

Violanda Theodhori – Ndërveprimi, i cili është parashikuar te neni i Qendrës së Informacionit për Studimin e të Dhënave, mund ta shtojmë edhe këtë.

Ilir Beqaj – Dakord.

Neni 8. Kush është dakord? Kundër? 1 votë, nga Valteri. Abstenim? 1 votë, nga zoti Gjuzi.

Kemi lënë edhe neni 3 pikën 19, “Mjetet lundruese”.

Violanda Theodhori – Ne e pamë ligjin e Kodit Detar, aty flitet edhe për regjistër të mjeteve lundruese, edhe për një libër të mjeteve të vogla lundruese. Po të themi: “...çdo mjet i destinuar për lundrim, sipas përcaktimeve të Kodit Detar”, mendoj se është e plotë, pasi ka dy terma të ndryshëm për regjistrat. Pra, mendoj se Kodi Detar i përfshin të dy regjistrimet.

Ilir Beqaj – Po flasim për regjistrimin. Kjo e shprehur kështu...

Violanda Theodhori – Po, për regjistrimin, ose mund të themi: “...regjistruar sipas përcaktimeve të Kodit Detar”

Ilir Beqaj – Dakord, të shtojmë fjalën “i regjistruar”.

Kush është dakord me këtë riformulim të pikës 19? Abstenim? 1 votë, nga zoti Gjuzi. Kundër?

Miratohet.

Kthehemi te neni 17. Për herë të parë në pikën “dh” përmendim teleferikët.

Violanda Theodhori – Edhe në ligjin ekzistues, sigurimi i pasagjerëve nga aksidentet e transportit publik, ka qenë sigurimi i pasagjerëve të teleferikëve dhe mjeteve të transportit mbi shina. Pra, bëhet fjalë për të gjithë pasagjerët. Kjo është një kontratë e ndryshme nga kontrata për përgjegjësinë e palëve të treta, të cilën e diskutuam deri tani për mjetet e transportit. Bëhet fjalë vetëm për aksidentet në transportin publik. Po të shikojmë edhe nenet e tjera, aty janë përcaktuar edhe mbulimet...

Ilir Beqaj – Dakord, meqenëse po flasim për teleferikun, bëj një pyetje pak provokuese, po për ashensorët?

Violanda Theodhori – Ato janë te ligjet e ndërtimit. Është një paketë e tërë për sigurinë e ndërtesave apo përgjegjësive të ndërtuesit. Këtë e kemi diskutuar në komision më përpara.

Ilir Beqaj – Ajo është në momentin e ndërtimit, por fjala është kur godina ka mbaruar, jo kur ndërtohet.

Violanda Theodhori – Po, për këtë janë proceset e kolaudimit, ku 10 vjet janë në përgjegjësi të ndërtuesit, pas ndërtimit të godinës. Pra, është një paketë e tërë masash që qeveria ka marrë për të rregulluar problemin apo cilësinë e ndërtimeve.

Këtu flasim për pasagjerë. Ndërsa kur ne hipim në ashensor ose jemi banorë, ose vizitorë në një apartament të caktuar, ose në një qendër tregtare dhe nuk quhemi pasagjerë.

Ilir Beqaj – Dakord. Te shkronja “c” vendosja e presjes pas fjalës “me qira” do të thotë që pjesa e dytë e fjalisë vlen edhe për taksitë, edhe për makinat me qira?

Violanda Theodhori – Po, për secilën duhet të jetë.

Ilir Beqaj – Dakord, nëse e është për të dyja presja është në rregull. Pra pyetja është nëse e keni për të dyja apo vetëm për pjesën e dytë, që janë makinat me qira.

Violanda Theodhori – Po, për të dyja.

Ilir Beqaj – Kam një pyetje, sot ka shoqëri taksish, të cilat një autoveturë taksitë e përdorin me disa shoferë. Pra, shoferët mund të ndryshojnë, sepse janë punonjës që punojnë me turne, përveç rasteve klasike, kur taksisti është edhe pronar i mjetit. Tani që kanë filluar shoqëritë e taksive, ai ka një flotë me 20 taksitë dhe ka 40 shoferë...

Violanda Theodhori – Po, pronari i lidh kontratat për mjetin taksitë.

Ilir Beqaj – Po, por ju thonë: “Kur jepen së bashku me drejtuesit”

Violanda Theodhori – Kontrata lidhet me pronarin e taksive dhe të makinave me qira kur jepen së bashku me drejtuesin.

Ilir Beqaj – Çfarë do të thuash me këtë gjë, këtë bashkë me drejtuesin, sepse atë e kuptoj për taksitë dhe makinat me qira? Unë e marr makinën me qira dhe jam unë dhe makina, por në rastin e një flote taksitë, shoferët janë më shumë se taksitë, sepse punojnë me turne, pra si realizohen?

Violanda Theodhori – Kryetar, do të më lini kohë ta rishikoj dhe do t’ju kthej përgjigje.

Ilir Beqaj – Dakord.

Atëherë, nuk do ta mbyllim nënin 17.

Rishikojeni tani, sepse sot do ta ezaurojmë diskutimin nënin për nënin.

Violanda Theodhori – Po, do ta rishikojmë sot.

Ilir Beqaj – Ndërkohë që ju flisni bashkëpunëtorët tuaj mund ta shikojnë.

Kalojmë te nëni 18.

Pse ka lindur nevoja për pikën 2 të nenit 18?

Violanda Theodhori – Ky parashikim ka qenë dhe kështu është edhe në ligjet e tjera.

Për personin, që është pa autorizimin e pronarit të avionit ose ekuipazhit, mund të jetë ...

Nuk i vlerëson si pasagjerë.

Ilir Beqaj – Çfarë mund të jenë këta?

Violanda Theodhori – Urdhëroni!

Ilir Beqaj – Si mund të ndodhë të jenë të tillë?

Violanda Theodhori – Mund të ndodhë, si, për shembull, rasti i Rinasit ose i një vjedhjeje, që futen pa leje në territor dhe gjenden në avion, persona që nuk kanë autorizim të pronarit të avionit apo persona që furnizojnë me naftë, të cilët nuk kanë autorizim të hyjnë atje dhe ndodh një aksident, nuk mbulohen.

Ilir Beqaj – E kuptova.

Violanda Theodhori – Domethënë, ngjarjet mund të jenë të ndryshme.

Ilir Beqaj – Pse kjo gjë ndodh vetëm për avionin? Mund të ndodhë edhe për diçka tjetër?

Violanda Theodhori – Personat e tjerë janë të gjithë të mbuluar, siç është te pika 1, si personat që ndodhen pranë aeroportit, ata që janë duke hipur ose duke zbritur. Pra, është e përjashtuar për të gjithë ata që kanë autorizim të hyjnë ose ndodhen aty për një qëllim. Kështu kanë qenë modelet.

Për avionin është më specifike.

Ilir Beqaj – Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Nuk ka. Abstenim? zot Gjuzi.

Miratohet.

Neni 19.

Unë kam një pyetje për pikën 2.

Nuk e di nëse keni ndonjë rregullim më tej, por ju vendosni shumat e sigurimit minimal në pikën 2, apo jo? Këto shuma ngelen të ngrira edhe pas 5 vjetësh?

Violanda Theodhori – Po, këtu nuk ka ...

Ilir Beqaj – Ka ndonjë mekanizëm tjetër rregullues?

Violanda Theodhori – Këtu janë të përcaktuara kushtet se kur jepet ky mbulim, ndërsa për pjesën tjetër janë të mbuluara nga TPL-ja, pra rasti madhor.

Ilir Beqaj – Më falni, sepse ndoshta nuk u shpreha qartë!

Ju keni thënë këtu se minimumi është 2 milionë, një shifër, nuk ka rëndësi, apo jo?

Pas 5 vjetësh, kjo shifër, do të ngelet 2 milionë?

Violanda Theodhori – Po.

Ilir Beqaj – Pse?

Violanda Theodhori – Nga modelet që kemi parë shifrat janë shumë të vogla dhe rastet janë shumë të pakta.

Ilir Beqaj – Nuk ka rëndësi.

Parimisht, nuk duhen indeksuar këto vlera?

Ka ndonjë mekanizëm vetërregullues, që të indeksojë përgjithësisht, sepse do të vijnë edhe nene të tjera?

Violanda Theodhori – Te neni 25 kemi një indeksim, por këtu nuk është parashikuar.

Ilir Beqaj – A duhet t'i përfshijmë në parim indeksimet në përgjithësi?

Robert Bitri – Si e ka rregullorja? A duhet të indeksohet? Iliri ka të drejtë. Nëse duhet të indeksohet, duhet lënë e hapur ajo pjesë, nuk kemi pse ta mbyllim ne me 2.

Ilir Beqaj – Duhet rregulluar përgjithësisht indeksimi.

Violanda Theodhori – Dakord.

Ilir Beqaj – Cilat janë eksperiencat e vendeve të tjera?

Nëse ne do të bëjmë një ligj të mirë, mund të mos ndryshohet për ikx vjet.

Violanda Theodhori – Do ta shikojmë, zoti kryetar, dhe do ta diskutojmë.

Ilir Beqaj – Sa ka qenë para 10 vjetësh në ligjin bazë? Ligji bazë ka qenë në vitin 2009. Sa e ka pasur këtë vlerë ligji i vitit 2009? Apo nuk ka pasur?

Violanda Theodhori – Këtu e kemi shtuar rastin e paaftësisë së përkohshme, trajnimet mjekësore...

Ilir Beqaj – Më falni!

Në parim, ligji i vitit 2009 ka pasur vlera minimale?

Violanda Theodhori – Po.

Ilir Beqaj – Ka pasur mekanizëm indeksimi?

Violanda Theodhori – Jo.

Ilir Beqaj – Si mund ta lëmë, për shembull, 12 vjet minimumin? Shtrenjtimi i jetesës, i kostove nuk duhet reflektuar në këtë gjë? Pyes në parim, por bëra këtë ilustrim, sepse jemi në

momentin kur kemi shifrën. Më pas, ka nene të tjera, që nuk dua ta vazhdoj sërish. Domethënë, ta mbyllim këtu.

Kolegë, unë propozoj t'i rekomandojmë komisionit përgjegjës për të vlerësuar në përgjithësi çështjen e indeksimit. Si mendoni?

Votojmë nenin 18.

Kush është dakord?

Robert Bitri – Ilir, edhe një herë, si the?

Ilir Beqaj – Berti, propozova që Komisionit përgjegjës të Ekonomisë t'i rekomandojmë të shikojë në përgjithësi në parim indeksimin.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Nuk ka. Abstenim? zoti Gjuzi.

Neni 20.

Kam një pyetje, fjalia fillon: “Pasagjeri ose përfituesi ka të drejtë, sipas kushteve të kësaj kontrate”. Të cilës kontratë?

Violanda Theodhori – Kontratës së pasagjerëve dhe transportit publik.

Ilir Beqaj – Duhet shtjelluar? Sepse është fjali e ngelur ...

Mënyra se si është formuluar është si nen kontrate, jo si nen ligji.

Violanda Theodhori – Mendojmë se është brenda kreut III, me titull të ndarë, ndaj kemi menduar se është e qartë.

Ilir Beqaj – Atëherë, kontratës së sigurimit, sepse, sipas kësaj kontrate, më duket si e lënë ...

Violanda Theodhori – Meqenëse është brenda kreut dhe flitet për kontratën e sigurimit të pasagjerëve të transportit publik, kemi menduar të mos përsërisim fjalë.

Ilir Beqaj – Atëherë, nëse do të jetë kështu, nuk do ta vinit, sepse kuptohet që flet për këtë nen.

Fakti që ka lindur nevoja, sipas kushteve të kësaj kontrate, ose, të paktën, kushteve të kontratës, sepse, kur thua “kësaj”, duket sikur është teksti i vetë kontratës nga ana gjuhësore.

Robert Bitri – Duhet shtuar fjala e sigurimit, keni të drejtë, sepse detyrimi për lidhjen e kontratës së sigurimit është më i qartë.

Ilir Beqaj – Edhe mënyra e të shprehurit “të kësaj”, duket sikur është teksti i kontratës, jo ligji që rregullon kontratën.

Violanda Theodhori – Jemi dakord me riformulimin, kryetar.

Ilir Beqaj – Mund të shprehemi: “Sipas kushteve të kontratës së sigurimit”?

Violanda Theodhori – Po.

Ilir Beqaj – Dakord.

Te pika 2 ju thoni se pronari i lejeve të transportit publik të vendosë në një vend të dukshëm të mjetit shoqërinë e sigurimit. Edhe në një taksi të vihet kontrata? Duket si ...

Violanda Theodhori – Kjo është për transparencë. Kështu e ka edhe direktiva.

Ilir Beqaj – Ndjesë, por në taksi në Europë nuk kemi parë kontratë sigurimi e të tjera.

Violanda Theodhori – Jo kontratën, por një shënim duhet ta japë.

Gjithsesi, si ta vlerësoni.

Ilir Beqaj – Nejse. Hedhim në votim nenin 20. Kush është dakord me ndryshimin që bëmë te pika 1? Kundër? Abstenim? Zoti Gjuzi.

Miratohet.

Kalojmë te kreu IV “Sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë së pronarit në mjetin motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.”

Neni 21. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Zoti Gjuzi.

Miratohet.

Neni 22 “Përjashtimi nga mbulimi në sigurim”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Zoti Gjuzi.

Miratohet.

Neni 23 “Humbja e së drejtës së mbulimit në sigurim”.

Në pikën e parë të këtij neni thuhet: “Drejtuesi nuk e përdor mjetin në përputhje me qëllimin për të cilin ai është i destinuar të përdoret”. Çfarë do të thotë kjo?

Violanda Theodhori – Mjeti është mjet transporti, mund të jetë autoveturë e destinuar për njerëz, por mban mallra, dhe mund të bëjë aksident pikërisht nga ngarkesa. Pra, nëse është një autoveturë, që është për 4 persona, po të bëjë aktivitet tjetër jo të zakonshëm, për shembull, të transportojë mallra, të bëjë gara sportive, nëse nuk e ka destinacionin. Gjithashtu, mjet tjetër, për shembull, është kamioni që është për mallra, por merr pasagjer. Pra, kjo është të dalë nga destinacioni i tij, ose për shembull një kamion që ka destinacion për të transportuar çimento, të bëjë gjëra të tjera, ose një mjet frigorifer të transportojë njerëz.

Ilir Beqaj - Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Zoti Gjuzi.

Miratohet.

Neni 24 “Dëmshpërblimi për dëmin e shkaktuar nga personi i paautorizuar.” Kush është dakord ? Kundër? Abstenim? 2 abstenime, zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni.

Miratohet.

Neni 25 “Përgjegjësia e shoqërisë së sigurimit dhe shuma e siguruar”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? 2 abstenime, zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni.

Miratohet.

Violanda Theodhori – Ne kërkojmë një rregullim të një date.

Ilir Beqaj – Bëjeni te komisioni përgjegjës, i cili do t’i rregullojë të gjitha.

Violanda Theodhori – Dakord.

Ilir Beqaj - Neni 26 “Ndryshimi i pronësisë së mjetit”. Kush është dakord ? Kundër? Abstenim? 2 abstenime, zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni.

Miratohet.

Neni 27 “Sigurimi i mjeteve motorike për regjistrim të huaj”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? 2 abstenime, zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni.

Miratohet.

Neni 28 “E drejta për dëmshpërblim nga përdoruesi i mjetit motorik me karton jeshil.” Kush është dakord? Kundër? Abstenim? 2 abstenime, zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni.

Miratohet.

Neni 29 “E drejta e dëmshpërblimit në sigurimin kufitar.” Kush është dakord? Kundër? Abstenim? 2 abstenime, zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni.

Miratohet.

Neni 30 “Kërkesa për rimbursimin e mbajtësit të sigurimit shoqëror.”

Unë kam një sugjerim, meqenëse në titull kemi thënë “Sigurim shoqëror”, ndërsa në tekst në pikën 1 thuhet: “Dëmet që mbulojnë sigurimet e shëndetit, pensionit, paaftësisë...”, a mundet të themi “sigurimit shoqëror dhe shëndetësor” në titull?

Violanda Theodhori – Po.

Ilir Beqaj - Kush është dakord me shtesën “dhe shëndetësor” në titull? Kundër? Abstenim? 2 abstenime, zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni.

Miratohet.

Kreu V “Qendra e informacionit të sigurimeve të detyrueshme.” Meqenëse e kemi cituar dy herë gjatë diskutimeve këtë nen, unë kam një koment të vogël te pika 6, ku thuhet: “Në

rastin e përpunimeve dhe të mbledhjes së të dhënave personale zbatohet ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar””. A mund të themi më mirë legjislacioni, sepse është më e plotë?

Violanda Theodhori – Dakord.

Ilir Beqaj- Së dyti, me sa e kuptoj unë rëndësinë e kësaj qendre, do të duhet që kjo qendër, në mënyrë që të garantojë ndërveprimin, duhet të funksionojë sipas legjislacionit të bazave të të dhënave shtetërore. Kemi legjislacion në Shqipëri për bazat e të dhënave shtetërore. Pra në momentin që këtë dispozitë në ligj, ju bëni një kërkesë, pra kur të krijohet qendra, do të bëhet një kërkesë për të krijuar bazën e të dhënave shtetërore dhe më pas del një vendim i veçantë qeverie, për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, përkufizimin duhet ta dini ju, e cila më pas ju jep atë që kërkon ju, mundësinë e ndërveprimit.

Ngritja e kësaj qendre në bazë të atij legjislacioni ju jep mundësinë të qarkullimi në *government gateway*.

Violanda Theodhori – Zoti kryetar, më lejoni t’ju them diçka!

Ne kemi qenë dhe jemi në bashkëveprim me AKSHI-n dhe kemi bërë disa takime, si dhe me Ministrinë e Financave dhe me përfaqësues të Këshillit të Ministrave lidhur me këto propozime dhe është rënë dakord që të vihet një fjali, e shkëmbimit të të dhënave dytësore.

Ilir Beqaj – Ku është fjalia, në cilën pikë?

Violanda Theodhori – Është te neni 34/2.

Ilir Beqaj – Jemi në një nen tjetër, sipas kësaj që thoni ju, por nuk kemi ardhur ende te ky nen.

Violanda Theodhori - Jemi në proces regjistrimi, por jemi edhe në proces diskutimi me AKSHI-n.

Ilir Beqaj – Kam përshtypjen që prapë, me aq sa po shoh këtu, *database*-n shtetërore sikur nuk e citoni?

Megjithatë, nëse ju thoni që nga diskutimet me AKSHI-n keni rënë dakord dhe ky është formulimi që duhet, atëherë jemi në rregull.

Hedhim në votim nenin 31, me korrektimin e vogël që iu bë pikës 6. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Shtjefni dhe zoti Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 32. Kush është dakord? Abstenim? Kolegët Shtjefni dhe Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 33 “Dhënia e informacionit nga shoqëria e sigurimit”. Kush është dakord? Abstenim? Kolegët Gjuzi dhe Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 34.

Në nenin 34...

Kujtim Gjuzi – Kryetar, me leje!

Ilir Beqaj – Një sekondë, të lutem!

...pikën 5 të këtij neni a e keni diskutuar ju me AKSHI-n?

Violanda Theodhori – Po, edhe me përfaqësues nga Kryeministria dhe nga Ministria e Financave dhe ky është versioni përfundimtar që ka ardhur nga Këshilli i Ministrave pas diskutimeve.

Ilir Beqaj – E kuptoj, por ka në shprehje “përcaktohet me akt nënligjor”?

Ne nuk e përdorim më këtë teknikë, por më shumë përdorim VKM, ose udhëzim, marrëveshje ose rregullore, por jo akt nënligjor?

Violanda Theodhori – Meqë këtu janë edhe ministrinë besoj se për ministrinë do të dalë një VKM besoj.

Ilir Beqaj – Atëherë, ose do të themi VKM, udhëzim ose...

Më falni, a del dot një udhëzim...

Nuk del dot një udhëzim i përbashkët ndërmjet AMF-së dhe një ministri formalisht.

As VKM-ja nuk del dot. Për mendimin tim AMF-ja vetëm mund të lidhë marrëveshje me institucionet qeveritare.

Violanda Theodhori – Zoti kryetar, ne marrëveshje kemi pasur për shkëmbimin për qendrën, marrëveshje të veçanta, por mund të bëhet edhe një marrëveshje e përbashkët.

Ilir Beqaj – Po fjala “akt nënligjor”? Kam frikë se marrëveshja e përbashkët nuk është më akt nënligjor?

Ju lutem, ky term duhet saktësuar!

Do të kërkoj një kompetencë edhe nga Komisioni i Ligjeve, pasi kjo shprehja nuk më ecën.

Kam edhe një pyetje të fundit po për këtë nen. A duhet të vëmë një afat kur krijohet kjo qendra?

Violanda Theodhori – Qendra ekziston në autoritet, thjesht është pjesë e departamenteve të strukturës së autoritetit, kështu që këtu vetëm nëse do të përmirësohet pozicioni i qendrës. Modele të vendeve të ndryshme janë të ndryshme, pasi ka qendra që janë jashtë Autoriteteve Mbikëqyrëse...

Ilir Beqaj – Kjo nuk ka rëndësi, sepse nuk ka fare rëndësi se ku është, por e rëndësishme është...

Ju sot na thatë se nuk ndërveproni me disa institucione të caktuara, jeni duke bërë studime e të tjera. Vetë rregulloret e gjërat e tjera po nuk qenë ato në fuqi, atëherë qendra nuk mund të funksionojë e plotë, apo jo?

Violanda Theodhori – Qendra ka disa vite që është funksionale dhe bashkëveprimi me institucionet ka qenë në bazë të marrëveshjeve që kemi pasur dhe është funksional. E gjithë kjo bëhet për përmirësime të mëtejshme të zhvillimeve...

Ilir Beqaj – A ka nevojë për investime shtesë që qendra të jetë funksionale?

Violanda Theodhori – Qendra ka vazhdimisht zhvillime, sidomos sa u takon regjistrave të rinj dhe kontributet janë nga shoqëritë e sigurimeve...

Ilir Beqaj – Jam dakord me pjesën se kush e financon, por a duhet një afat apo automatikisht me hyrjen e ligjit në fuqi ju thoni që e keni gati?

Violanda Theodhori – Po.

Ilir Beqaj – Kush është dakord me nenin 34?

E kaluam nenin 33? Po.

Po me termin “përcaktohen me” çfarë doni të thoni? Kjo është me marrëveshje apo me...

Si i keni sot marrëveshjet?

Violanda Theodhori – Kemi pasur marrëveshje treshe me Ministrinë e Brendshme dhe me Ministrinë e Transportit, kemi pasur me policinë, me DPSHTRR-në...

Ilir Beqaj – Me marrëveshje?

Atëherë këtu ta shprehim “përcaktohet me aktmarrëveshje” jo me “akt nënligjor”

Dakord!

Hedhim në votim nenin 34. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni. Miratohet.

Kreu VI “Byroja Shqiptare e Sigurimit, fondi i garancisë dhe fondi i kompensimit”.

Neni 35. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 36. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 37. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 38, “Administrimi i fondit të garancisë së kartonit jeshil”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 39, “Trajtimi i dëmeve të ndodhura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 40, “Kërkesa për dëmshpërblim”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 41, “Fondi i kompensimit”. Në pikën 2 ju thoni që vlera minimale e fondit nuk mund të jetë më e vogël se 150 milionë lekë, në mos gaboj. A nuk do të ishte më mirë që këto të kishin një korrelacion në përqindje me fondin e sigurimit të detyrueshëm, si parim, pavarësisht nga vlera, si rezervë?

Violanda Theodhori – Shtimi i fondit të kompensimit në këto nene dhe në këtë kapitull ka ndryshuar dhe këtu është një fond garancie, është minimalja. Më pas ka edhe pagesa të tjera, por kjo është minimalja që do të mbahet për dëmet a, b, c, që janë të listuara, dhe një sërë dëmsh të tjera për makina të pasiguruara do të kalojnë drejtpërdrejt te shoqëritë e sigurimit. Pra, përqindjen që ato marrin në treg, do ta marrin indirekt me pagesën e këtyre dëmeve.

Ilir Beqaj – E hedhim në votim nenin 41, “Fondi i kompensimit”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 42, “Pagesa e kontributeve në fondin e kompensimit”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 43, “Trajtimi dhe pagesa e drejtpërdrejtë nga shoqëria e sigurimit”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 44, “Dëmshpërblimi i dëmeve të shkaktuara nga përdorimi i një mjeti motorik të pasiguruar”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 45, “Dëmshpërblimi ndaj pasagjerit në transportin publik”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Shtjefni...

Miratohet.

Neni 47, “Dëmshpërblimi i dëmit në rast të likuidimit apo falimentimit të shoqërisë së sigurimit”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi.

Miratohet.

Neni 48, “Administrimi i fondit të kompensimit”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi.

Miratohet.

Neni 49, “Pasqyrat financiare të Byrosë”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Shtjefni dhe Gjuzi.

Miratohet.

Kreu VII “Sigurimi i përgjegjësisë së pronarëve të mjeteve lundruese për dëmin e shkaktuar palëve të treta”.

Neni 50. A mos duhet të bëjmë një saktësim në pikën 1? Se këtu thuhet: “15 kw”. Çfarë keni parasysh me 15 kw?

Violanda Theodhori – Kilovat për orë.

Ilir Beqaj – Kilovat për orë?!

Violanda Theodhori – Kështu e ka dhe ligji për mjetet lundruese. Në fakt, është për kuaj fuqi.

Ilir Beqaj – Ka dhe një *gross* tonazh.

Zoti Pëllumbi, urdhëroni!

Violanda Theodhori – Ligji për mjetet lundruese i ka të dyja, edhe kw/orë dhe/ose kuaj fuqi dhe e përkthen në kf. Ka edhe nën tonazhin 500 *gross* tonë, gT.

Ilir Beqaj – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Doja të bëja një sqarim në lidhje me matjet. 15 kilovat është mënyra se si matet një fuqi dhe që ka një korrelacion të caktuar me kuajt fuqi. *Gross tonazhi* ka të bëjë me peshën e mjetit. Pra, janë dy gjëra krejt të ndryshme: kjo mat motorin, ajo mat peshën. Matet me kilovat apo me kuaj fuqi, këto janë dy mënyra të shprehuri, që kanë një korrelacion me njëra-tjetrën. Pra, këtu bëhet fjalë për fuqinë e motorit.

Ilir Beqaj – E kuptova.

Ju thatë dje për të konsultuar diçka për legjislacionin që kemi miratuar.

Violanda Theodhori – Po, e konsultuam, zoti kryetar. Ligji “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit”, përfshin mjetin me kapacitet 12 pasagjerë, me fuqi mbi 30 kilovat dhe që përfshihet në tonën, sepse ne e kemi me fuqi motorike më të madhe se 15, pra hyjnë dhe këto që janë 30. Në nenin 5 ky ligj kishte edhe policën e sigurimit për dëmet ndaj të tretëve dhe ne mendojmë se ka dashur të bëjë referencë në këtë ligj, që është e njëjta gjë, për palët e treta, për përgjegjësinë, pavarësisht se si është shprehur aty. Ne e kemi më të gjerë fushën, se e kemi mbi 15. Këtu flitet për 30 dhe pastaj e kthen në kuaj fuqi.

Ilir Beqaj – Atëherë, kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Gjuzi dhe Shtjefni.

Miratohet.

Neni 51, “Shuma e sigurimit”. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Shtjefni dhe zoti Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet

Kreu VIII “Sigurimi i përgjegjësive së pronarëve të avionëve për dëmin e shkaktuar palëve të treta”.

Neni 52 “Detyrimi për të lidhur kontratën e sigurimit”. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet .

Neni 53 “Përgjegjësia e marrjes në sigurim dhe shuma e siguruar”. Kam një pyetje.

Pse keni zgjedhur të punoni me SDR?

Violanda Theodhori - Këto janë standardet edhe te Kodi Ajror, edhe te përcaktimet.

Iliri Beqaj- A mendoni se duhen lënë shprehjet në anglisht?

Vjolanda Theodhori – Edhe Kodi Ajror i ka lënë në kllapa anglisht, kështu që ndoshta është më mirë për përcaktimet.

Iliri Beqaj- Kush është dakord? Abstenim? Zoti Shtjefni dhe zoti Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu IX “Kundërvajtjet administrative”.

Neni 54 “Masat administrative të Autoritetit”. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Shtjefni dhe zoti Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet .

Neni 55 “Shkelja e dispozitave nga shoqëria e sigurimit”. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 56. Për koherencë, te neni 55 thuhet: “Shkeljen e dispozitave nga...”, mos duhet t’i shtojmë edhe këtu fjalët “shkeljen e dispozitave” për të qenë të saktë?

Violanda Theodhori - Po.

Ilir Beqaj- Kush është dakord me saktësimin tek titulli? Abstenim? Zoti Shtjefni dhe zoti Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 57, për të qenë skollastik deri në fund, ta themi edhe këtu: “Përsëritja e shkeljeve të dispozitave”?

Vjolanda Theodhori - Po.

Ilir Beqaj- Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu x “Dispozita kalimtare”.

Neni 58 “Nxjerrja e akteve nënligjore”. Si e mendoni afatin 90-ditorë?

Violanda Theodhori - Ju falënderoj, kryetar, për sugjerimin, edhe ne e diskutuam dhe jemi dakord që të bëhet 180 ditë.

Ilir Beqaj - Pra, te neni 58, edhe në pikën 1, edhe në pikën 2, edhe në pikën 3 afati, ku thuhet brenda 90 ditëve, të bëhet 180 ditë dhe të bëhet saktësimi ministri përgjegjës për mbrojtjen. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Shtjefni dhe zoti Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 59. Edhe këtu kemi afate, të cilat mendoj t'i shprehim në ditë dhe jo në muaj. Atëherë, në pikat 1 dhe 2 fjalët “brenda 3 muajve” të bëhen “brenda 180 ditëve”. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Shtjefni dhe zoti Gjuzi. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 60 “Shfuqizimet”. Kam një pyetje. E supozojmë që ligji shfuqizohet në ditën që votohet, themi e kap data 10 maj, nga data 11 maj, për 180 ditë që nuk ka akte nënligjore, si zgjidhet praktikisht në zbatim e sipër kjo gjë?

Violanda Theodhori - Ne e diskutuam dje, meqenëse do të shtoheshin afatet e rregulloreve, për të bërë një dispozitë transitore për përshtatjen deri në..

Ilir Beqaj – Pse nuk e propozuat, sepse ne erdhëm te hyrja në fuqi.

Violanda Theodhori – Të zbatohen dispozitat e këtij ligji dhe ato rregulloret që janë ekzistuese dhe nuk bien në kundërshtim derisa të dalin aktet e reja.

Ilir Beqaj - Përveç parimit, si duhet të ishte formulimi i saktë i dispozitës?

Atëherë, e zgjidhim me rekomandim me komisionin përgjegjës.

Kolegë, a jeni dakord që t'i rekomandojmë komisionit përgjegjës të marrë në konsideratë edhe periudhën e tranzicionit dhe derisa të miratohen aktet nënligjore ta zgjidhim me dispozitën? Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 61 “Hyrja në fuqi”. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Abstenim? Zoti Gjuzi dhe zoti Shtjefni. Kundër? Nuk ka.

Miratohet ligji “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Faleminderit kolegë!

Përgëzime propozuesve! Punë të mbarë dhe suksese në zbatimin e ligjit!

Meqenëse të hënën ka seancë, e vazhdojmë të martën mbledhjen e komisionit për ligjin “Për eficiencën e energjisë”.

Ditë mbarë, faleminderit!

Violanda Theodhori - Ju falënderojmë për vëmendjen, profesionalizimin dhe sugjerimet që dhatë për përmirësimin e projektligjit!

Ilir Beqaj – Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA